



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2024:064042  
Datë: 29.05.2024  
Numri i dokumentit: 05748810

**PPP.nr.19/24**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbartimore të kreditorëve R.B. dhe S.B., të cilët i përfaqëson av Besmir Rrahmani nga Ferizaj, kundër debitorit “LZ I.” SH.P.K, me seli në Ferizaj, me numër të biznesit ..., me seli në Ferizaj rr “...”, me përfaqësues Xh.L., të cilin e përfaqëson me autorizim Nj.H., për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga i autorizuari i debitorit, me datë 29.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** në tërësi si i pabazuar prapësimi i të autorizuarit të debitorit “LZ I.” SH.P.K, i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.66/2024, i datës 26.01.2024, i lëshuar nga përmbartuesi privat B.A. nga Ferizaj dhe **MBETET në fuqi** urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.66/2024, i datës 26.01.2024.

**A r s y e t i m**

Me urdhrin P.nr.66/2024, të datës 26.01.2024, përmbartuesi privat B.A., e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve R.B. dhe S.B., kundër debitorit “LZ I.” SH.P.K, për detyrimin e debitorit, për pagesën e borxhit në shumë të përgjithshme prej 189,900.00 euro dhe shpenzimet e procedurës së përmbartimit, në bazë të Kontrates Noteriale, LRP.Nr.6.../2019 dhe REF.Nr.2.../2019, e datës 08.05.2019 dhe aneks kontratës LRP.Nr.1.../2020 dhe REF.Nr.5.../202, e datës 28.01.2020, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajshme dhe të paluajshme të debitorit.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, i autorizuari i debitorit, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që prapësimi të pranohet si i bazuar dhe të anulohet urdhri për përmbarim.

I autorizuari i kreditorëve, në përgjigjen e ushtruar me shkrim, në prapësimin e të autorizuarit të debitorit, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar, ndërsa urdhri për caktimin e përmbarimit të mbetet në fuqi.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin mbi lejimin e përmbarimit dhe pretendimet në prapësim të autorizuarit të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi në fjalë është i pabazuar dhe nuk i plotëson asnjërin nga kushtet e parapara me nenin 71, par 1, të LPP-së.

Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarim P.nr.66/2024, i datës 26.01.2024, i lëshuar nga përmbaruesi privat B.A., është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbarimore ngase përmbaruesi privat e ka nxjerrë urdhrin për përmbarim duke e lejuar përmbarimin e propozuar në pajtim të plotë me nenin 22, par 1, nën par 1.3, të LPP-së.

Sa i përket pretendimit të autorizuarit të debitorit në prapësim se: kreditorët para përmbaruesit privat kanë paraqitur propozimin për përmbarim në bazë të aktit noterial me numër LRP.nr.6.../2019 dhe Ref.nr.2.../2019, për të cilin propozim përmbaruesi privat e ka caktuar urdhrin. Në këtë propozim ka përfshirë edhe lokalin afarist ku kreditorët këtë lokal e kanë lëshuar qysh moti kohë me qera dhe nga ky lokal gjenerojn të hyra mujore dhe po ashtu dëshirojnë të gjenerojnë edhe të hyra të tjera në mënyrë krejtësisht të kundërligjshme dhe po ashtu ka përfshirë edhe banesa të cilat kreditorët i kanë shitur qysh më herët ndërsa qeranë e kanë kërkuar deri me datën 31.01.2024, gjykata këto pretendime i konsideron të pa bazuara për arsye se nga prapësimi i ushtruar nga i autorizuari i debitorit gjykata gjen se i njëjti nuk i ka bashkangjitur prapësimin asnjë provë të vetme në bazë të cilës do të vërtetohet pretendimi apo pretendimet e tija në prapësim. Për më tepër në bazë të nenit 69 par.4 të LPP-së, është paraparë shprehimisht se “ *baza për prapësim duhet të mbështetet në provat e duhura*”. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet. Gjithashtu edhe nga përgjigjja e ushtruar me shkrim në prapësimin e debitorit nga i autorizuari i kreditorëve nuk shihet se i njëjti të ketë deklaruar se lokalet apo banesat që janë objekt i kontratave noteriale në fjalë janë lëshuar me qira.

Gjithashtu sa i përket pretendimit tjetër të autorizuarit të debitorit në prapësim se është arritur parashkrimi i kësaj kërkesë, gjykata edhe këtë pretendim e konsideron të pa bazuar sepse në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrimin e kërkesës së kreditorëve për arsye se

duke e krahasuar datën e dorëzimit të propozimit për përbarim nga i autorizuari i kreditorëve siç është dt.26.01.2024 dhe datës 28.01.2020, kur edhe është lidhur aneks kontrata në mes të palëve në këtë rast siç është aneks kontrata me nr.LRP.nr.1.../2020 dhe Ref.nr.5.../2020, nënkupton se në rastin konkret me vetë faktin e lidhjes së kësaj aneks kontrate nga kreditorët dhe debitori kemi të bëjmë me deklaratë të pranimit të borxhit, respektivisht janë plotësuar kushtet ligjore në neni 368, i LMD-së, në të cilin është paraparë shprehimisht edhe atë në par 1 dhe 2 se: “Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit , veç se edhe në mënyrë të tërthorët, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”. Për me tepër në nenin 355, par 1, të LMD-së është paraparë shprehimisht se kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për 3 (tri ) vite. Andaj, duke i marr për bazë faktet e përmendura më lart dhe duke e krahasuar periudhën kohore brenda të cilës është ushtruar propozimi për përbarim i kreditorëve, gjykata vjen në përfundim se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim apo vjetërsim të borxhit gjegjësisht nuk ka kaluar afati prej 3 viteve, i paraparë në nenin 355, par 1, të LMD-së.

Përveç tjerash, Gjykata konstaton se në rastin konkret Përbaruesi Privat B.A., urdhrin për përbarim të atakuar me prapësim, e ka nxjerrë në pajtim të plotë me nenin 22, par 1, nën par 1.3, të LPP-së, sepse në dispozitën ligjore të cekur më lart është paraparë shprehimisht se si dokument përbarimor në bazë të cilit mund të caktohet përbarimi nga organi përbarues është edhe kontrata e noterizuar tek noteri. Po ashtu, në nenin 43, par 1, të Ligjit Nr.06/L-010, për Noterinë, është përcaktuar shprehimisht se: “Dokumenti noterial është dokument përbarimor në qoftë se është përpiluar në formën e paraparë dhe nëse në të është përcaktuar kryerja e detyrimit të caktuar për të cilën palët mund të merren vesh dhe nëse përmban deklaratën e detyruesit për atë që në bazë të atij dokumenti, mundet, e me qëllim të realizimit të detyrimit, pas arritshmërisë së detyrimit, në mënyrë të drejtpërdrejt të zbatohet përbarimi i detyrueshëm”, dhe në bazë të akteve noteriale, gjegjësisht nenit 11.1, të kontratës së datës 08.05.2019, dhe nenit 2.1, të aneks kontratës së datës 28.01.2020, palët janë pajtuar me vullnetin e tyre të lirë para noterit se ky akt noterial paraqet titull ekzekutiv.

Gjithashtu, Gjykata konstatoj se në rastin konkret Përbaruesi Privat B.A., urdhrin për përbarim P.nr.66/2024, të datës 26.01.2024, e ka nxjerrë në pajtim të plotë me nenin 38, par 1, të LPP-së, sepse propozimi për përbarim i kreditorëve siç shihet i përmban dokumentet përbarimore në kopje të vërtetuar nga origjinali, kreditorin dhe debitorin, adresën e

vendbanimit dhe të selisë së tyre, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe të dhënat tjera të cilat janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.

Po ashtu, gjykata konstaton se kontratat e përmendura më lart janë në tërësi të përshtatshme për përmbarim, respektivisht në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, për arsye se në to janë treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Si përfundim, kjo gjykatë, duke i marrë parasysh të gjitha faktet e cekura më lart, pretendimet e të autorizuarit të debitorit në prapësim, përgjigjen e ushtruar në prapësimin e debitorit nga i autorizuari i kreditorëve, si dhe provat dhe shkresat tjera të lëndës, gjeti se prapësimi i të autorizuarit të debitorit, i ushtruar kundër urdhrin për përmbarim P.nr.66/2024, të datës 26.01.2024, është i pabazuar dhe vendosi që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, ndërsa urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**PPP.nr.19/24, më datë 29.05.2024**

**GJYQTARI**

**Faton Ajvazi**

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.